



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 179

Tiranë – E martë, 7 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 1.10.2025	Për lirim nga detyra..... 22091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 1.10.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë..... 22091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 1.10.2025	Për emërim në detyrë..... 22091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 1.10.2025	Për emërimin e dy anëtarëve të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve.... 22091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 1.10.2025	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2024, për Çështjen “Meli dhe <i>Swinkels Family Brewers N.V.</i> kundër Shqipërisë” (kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21) 22092
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 548, datë 1.10.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 286, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare” 22093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 550, datë 1.10.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar..... 22093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 1.10.2025	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore..... 22094

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 1.10.2025	Për shfuqizimin e vendimit nr. 79, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative 1, zona Autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e shoqërisë ‘Tirana DC’ sh.a., si njësi zbatuese”, të ndryshuar.....	22096
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 1.10.2025	Për krijimin e shoqërisë aksionare “MobAl” sh.a.....	22096
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 556, datë 1.10.2025	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Forumit të Investimeve midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13–14 tetor 2025.....	22097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 557, datë 1.10.2025	Për miratimin e rregullave të hollësishme, lidhur me kushtet, masat dhe kontrollet e ngarkesave të produkteve organike ose në kalim të importuara.....	22098
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 756/10, datë 2.10.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës–Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”, të ndryshuar.....	22102
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 836/5, datë 2.10.2025	Për një ndryshim në VKM-në nr. 61, datë 29.1.2025, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i fiderave me kabllo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias’, i ndryshuar”.....	22106
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 258/9, datë 3.10.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Zgjerimi i sipërfaqes së varrezave publike të qytetit të Peqinit”.....	22107

**VENDIM****Nr. 542, datë 1.10.2025****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Erjona Bejleri, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 543, datë 1.10.2025****PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 544, datë 1.10.2025****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Miriam Shyti emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 545, datë 1.10.2025****PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE
TË KOLEGJIT TË URDRHAVE DHE
MEDALJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e dy anëtarëve të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve, ekspertë të fushës së dekorimeve, si më poshtë vijon:

1. Z. Plator Kalakula;
2. Z. Jeronim Bazo.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 547, datë 1.10.2025

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.7.2024,
PËR ÇËSHTJEN “MELI DHE *SWINKELS*
FAMILY BREWERS N.V. KUNDËR
SHQIPËRISË” (KËRKESAT NR. 41373/21
DHE 48801/21)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2024, për çështjen “Meli dhe *Swinkels Family Brewers N.V.* kundër Shqipërisë”, përfundimtar në datën 16.10.2024, për kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

SHTOJCA 1

LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Numri i kërkesës	Titulli i çështjes	Kërkuesit	Dëm jopasuror ¹	Kostot dhe shpenzimet ²
41373/21	Meli kundër Shqipërisë	Astrit Meli	3 600 euro	4 000 euro
48801/21	Swinkels Family Brewers N.V. kundër Shqipërisë	Shoqëria “Swinkels Family Brewers N.V.	3 600 euro	6 000 euro

¹ Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.

² Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesve, sipas shtojcës 1, në vlerën që detyrohet shteti shqiptar, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2024, për çështjen “Meli dhe *Swinkels Family Brewers N.V.* kundër Shqipërisë”, përfundimtar në datën 16.10.2024, për kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesit Astrit Meli dhe shoqërisë kërkuese “*Swinkels Family Brewers N.V.*” të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM

Nr. 548, datë 1.10.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 286, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË KRYETARIT, NËNKRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR PAKICAT KOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 286, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Procedurat e përzgjedhjes për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhen nga komisioni *ad-hoc*, i cili kryesohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ka në përbërje një përfaqësues nga këto institucione:

- a) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- b) Akademia e Shkencave e Shqipërisë;
- c) Ministria e Punëve të Brendshme;
- ç) Ministria e Arsimit.”.

2. Pika 13 shfuqizohet.

3. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Komiteti për Pakicat Kombëtare për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 550, datë 1.10.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- Z. Blendi Gonxhja, ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- Z. Andis Salla, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Z. Ervin Demo, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 551, datë 1.10.2025

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË
BURIMEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në

përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për ushtrimin e aktivitetit sipas fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore.

Lista përbëhet, gjithsej, nga 1 (një) fletë formulari dhe 1 (një) plan rievimi, që u bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i ndalohej të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave të vecanta)

Identifikol: Mirlen Boci, Specialiste e Parë, Drejtoria Ligjore				Supervizoi: Inesa Adhami, Drejtor, Drejtoria Ligjore				Aprovoi: Erlind Sulo, Drejtor Ekzekutiv, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore			
Institucioni Qendror Shtetëror: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë											
Fusha e përdorimit të Pronës: Hidrokarbure dhe Minerare											
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës ha	Nga sipërfaqja totale		Funksioni për te cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhena të tjera (Shenime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	8531 FR-P-7	7/508	truall + Ndërtesë	"Depo e Kampionëve" , Fier, Rr" Lagjia 1 Maj"	2339.8	2339.8	1534.97	Magazinim	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Mbi këtë truall ndodhen 3 objekte 1 katëshe përkatesisht: Obj. 1=455.33m2 Obj. 2=446.48m2 Obj. 3=633.16m2. Total sipërfaqe ndërtimit =1534.97m2.
	8531 FR-P-7	7/432	Truall	"	236.6	236.6			"	"	
	8531 FR-P-7	7/109	Truall	"	420.6	420.6			"	"	
TOTAL		Truall + Ndërtesë			2997	2997	1534.97				

**VENDIM****Nr. 553, datë 1.10.2025****PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT
NR. 79, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E
ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA
ADMINISTRATIVE 1, ZONA
AUTOTRAKTORI, BASHKIA TIRANË,
DHE ÇAKTIMIN E SHOQËRISË
‘TIRANA DC’ SHA, SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktut normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 79, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative 1, zona Autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e shoqërisë “Tirana DC” sh.a., si njësi zbatuese”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, shoqëria “Tirana DC” sh.a., dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 554, datë 1.10.2025****PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË
AKSIONARE “MOBAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të

ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare, me kapital 100% shtetëror, me emërtimin “MobAl” sh.a., me qëllim ofrimin e shërbimit të operimit dhe organizimit të transportit publik rrugor.

2. Shoqëria “MobAl” sh.a., ofron kundrejt pagesës shërbimin e operimit dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.

3. Shoqëria “MobAl” sh.a., sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon me dy nivele administrimi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “MobAl” sh.a., është 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë. Vlera prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh transferohet nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pranë shoqërisë “MobAl” sh.a., menjëherë pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë dhe, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;

b) regjistrimin e shoqërisë “MobAl” sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6. Organet drejtuese të shoqërisë “MobAl” sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, janë Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, Administratorit, si dhe organizimi dhe funksionimi i shoqërisë janë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe parashikimeve në statutin e shoqërisë “MobAl” sh.a.

7. Shoqëria “MobAl” sh.a. ka si objekt të veprimtarisë:



a) operimin e shërbimit të transportit publik rrugor të udhëtarëve, përfshirë destinacionet turistike;

b) operimin e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve, përfshirë transportin e nxënësve dhe të punonjësve arsimorë;

c) organizimin dhe sigurimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës së operimit, përfshirë parkun e autobusëve, stacionet, infrastrukturën e karikimit për mjetet elektrike, sistemin e biletimit elektronik, serverat për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe çdo shërbim ose element tjetër të nevojshëm për funksionimin e shërbimit;

ç) arkëtimin e tarifës së biletave në mënyrë fizike ose elektronike;

d) organizimin, licencimin dhe monitorimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

dh) krijimin ose sigurimin e sistemeve e të aplikacioneve elektronike për menaxhimin, informacionin dhe monitorimin e shërbimeve të transportit publik rrugor të udhëtarëve.

8. Shoqëria “MobAl” sh.a. mund të ofrojë shërbime të tjera shitesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.

9. Shoqëria “MobAl” sh.a., financohet nga të ardhurat e veta nga ofrimi i shërbimeve dhe nga burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e shoqërisë aksionare përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

10. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, me qëllim përmbushjen e misionit të shoqërisë, siguron injektim kapitali për shoqërinë, brenda fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Transporti rrugor”.

11. Burimi i të ardhurave të shoqërisë “MobAl” sh.a. janë:

a) të ardhura nga arkëtimi i tarifës së biletës;

b) të ardhura nga tarifa vjetore, që përfitohet nga subjektet që kryejnë shërbimin e operimit të shërbimeve të transportit publik rrugor;

c) të ardhura të tjera të ligjshme, të cilat vijnë nga kryerja e veprimtarive sipas pikës 7 të këtij vendimi;

ç) grantet, huat, subvencionet.

12. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i siguron shoqërisë “MobAl” sh.a., mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

13. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2025, në programin “Transporti rrugor”.

14. Shërbimi i ofruar në shkronjën “c”, të pikës 7, të këtij vendimi, i fillon efektet në shtator të vitit 2026.

15. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 556, datë 1.10.2025

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË FORUMIT TË INVESTIMEVE MIDIS VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR, QË DO TË ZHVILLOHET NË TIRANË, NË DATAT 13–14 TETOR 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin 603 “Subvencione”, të programit 01320 “Shërbime qeveritare”, i shtohet fondi prej 31 753 000 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Forumit të Investimeve midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit



Perëndimor, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13–14 tetor 2025.

2. Efekti financiar, prej 31 753 000 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 557, datë 1.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME, LIDHUR ME
KUSHTET, MASAT DHE KONTROLLET
E NGARKESAVE TË PRODUKTEVE
ORGANIKE OSE NË KALIM TË
IMPORTUARA³**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 56, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e hollësishme për verifikimin e kushteve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre” (në vijim, ligji), dhe masat e marra gjatë

kontrollit të produkteve të importuara organike dhe/ose në kalim.

2. Rregullat e hollësishme, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshijnë:

a) kontrollet zyrtare për produktet që importohen nga një vend anëtar i Bashkimit Evropian ose vend i tretë, me qëllim vendosjen në tregun shqiptar si produkt organik dhe/ose në kalim;

b) deklarimet e komunikimet nga importuesi, operatori përgjegjës për ngarkesat, marrësi i parë dhe marrësi, për importin e produkteve nga Bashkimi Evropian dhe vendet e treta, me qëllim vendosjen e tyre në tregun shqiptar si produkte organike dhe/ose në kalim;

c) veprimet që duhet të ndërmerren nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në pikat e inspektimit kufitar, në rast të dyshimit ose të konstatimit të mospërputhshmërive të ngarkesave me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prodhimin organik.

Neni 2
Përkufizimet

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligj. Për efekt të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ngarkesë”, një numër kafshësh ose një sasi mallrash nën një ose më shumë kode të nomenklaturës doganore, të mbuluara nga një certifikatë e vetme zyrtare e operatorit organik, eksportuesit, dhe nga një deklaratë e vetme doganore, transportuar me të njëjtin mjet transporti dhe importuar nga i njëjti vend, që synohen të vendosen në tregun shqiptar si kafshë ose mallra organike dhe/ose në kalim.

2. “Pikë e kontrollit ose inspektimit kufitar” (në vijim PIK), një vend, përfshirë edhe ambientet që i përkasin atij, përcaktuar nga ministri për kryerjen e kontrolleve zyrtare të kafshëve dhe mallrave, përfshirë ato organike dhe/ose në kalim, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

³ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloret deleguese të Komisionit Evropian nr. 2021/2306, të datës 21 tetor 2021, që plotëson rregulloren nr. 2018/848, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, lidhur me rregullat mbi kontrollet zyrtare të ngarkesave të produkteve organike dhe në kalim, që synohen për import në Bashkimin Evropian, dhe për certifikatën e inspektimit dhe Faqe | 22098

rregulloren nr. 2021/2307, të datës 21 tetor 2021, që përcakton rregullat për dokumentacionin dhe njoftimet, që kërkojnë për produktet organike dhe në kalim, që synohen për import në Bashkimin Evropian. Numri CELEX: 32021R2306, GZ nr. 461, 27/12/2021, faqe 13–29 dhe numri CELEX 32021R2307, GZ nr. 461, 27/12/2021, p. 30–39.



3. “Kontroll i dokumentacionit”, kontrolli i certifikatës zyrtare të operatorit organik, që eksporton produkte organike dhe/ose në kalim, përfshirë dokumentet tregtare dhe dokumente të tjera, të cilat shoqërojnë ngarkesën, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar në PIK.

4. “Kontroll i identitetit”, inspektimi vizual për të verifikuar nëse përmbajtja dhe etiketimi i një ngarkese, duke përfshirë numrin e identifikimit të kafshës, vulat dhe mjetet e transportit, përputhen me informacionin e dhënë në certifikatën zyrtare të operatorit organik, eksportuesit dhe/ose dokumentet e tjera shoqëruese të ngarkesës.

5. “Kontroll fizik”, kontrolli i kafshëve ose i mallrave dhe, sipas rastit, kontrolli i ambalazhit, i mjetit të transportit, i etiketës, i temperaturës, marrja e mostrës për analizë, testimi ose diagnostikimi të kafshët dhe çdo kontroll tjetër për të verifikuar përputhshmërinë me rregullat e legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar dhe, në veçanti, për prodhimin organik.

6. “Importues”, një person fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri dhe subjekt i sistemit të kontrollit të certifikimit organik të përcaktuar në kreun V të ligjit, i cili është përgjegjës për importin e ngarkesës, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi.

7. “Operator përgjegjës për ngarkesën”, importuesi ose personi fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri, i cili paraqet ngarkesën në pikën e inspektimit kufitar në emër të importuesit.

8. “Marrës i parë”, një person fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri dhe që i nënshtrohet sistemit të kontrollit dhe certifikimit organik, të përcaktuar në kreun V të ligjit, të cilit i dorëzohet ngarkesa nga importuesi, pas çlirimit për qarkullim të lirë, për përgatitje të mëtejshme ose tregtim.

9. “Marrës”, një person fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri dhe që i nënshtrohet sistemit të kontrollit të certifikimit organik, të përcaktuar në kreun V të ligjit, të cilit i dorëzohet nga importuesi, pas çlirimit për qarkullim të lirë, një lot ose parti malli e përfutur nga ndarja e një ngarkese, për përgatitje të mëtejshme ose tregtim.

10. “TRACES”, platforma digjitale e Bashkimit Evropian, e cila përdoret për lëshimin e publikimin e certifikatës së operatorit organik, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Neni 3

Verifikimi i certifikatës së operatorit organik, që eksporton në Shqipëri

1. Certifikata e operatorit organik, që eksporton në Shqipëri, siç përcaktohet në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 55, të ligjit, gjendet e publikuar në sistemin TRACES, në *link*-un e mëposhtëm:

<https://webgate.ec.europa.eu/TRACESnt/directory/publication/organic-operator/index>

2. Ngarkesa e produkteve, që eksportohen në Shqipëri, siç përcaktohet në nënndarjen “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 55, të ligjit, shoqërohet me certifikatën e operatorit organik që eksporton, e cila përfshin produktet që eksportohen në Shqipëri.

3. Lista e vendeve të treta, të njohura nga Bashkimi Evropian si ekuivalente, dhe autoritetet e tyre kompetente, autoritetet e kontrollit dhe trupat e kontrollit, gjendet e publikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

4. Lista e vendeve të treta të njohura nga Bashkimi Evropian me marrëveshje tregtare dhe autoritetet e tyre kompetente, autoritetet e kontrollit dhe trupat e kontrollit, gjenden në *link*-un e mëposhtëm:

https://agriculture.ec.europa.eu/farming/organic-farming/trade/agreements-trade-organic-products_en

Neni 4

Regjistrimi e certifikimi i importuesit dhe gjurmueshmëria

1. Importuesi, marrësi i parë ose marrësi, që deklaron produktet organike ose në kalim, në PIK, të jetë i regjistruar dhe të ketë certifikatë të vlefshme si operator organik, siç përcaktohet në kreun V të ligjit, të lëshuar nga një trupë kontrolli e miratuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe e akredituar për fushën e certifikimit të importit të produkteve organike ose në kalim.

2. Lista e përditësuar e trupave të kontrollit të miratuara gjendet e publikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

3. Informacioni për gjurmueshmërinë e produktit organik dhe/ose në kalim, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 55, të ligjit, paraqitet sipas



kërkesës të trupa e kontrollit të importuesit ose institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK.

Neni 5

Njoftimi paraprak i mbërritjes së ngarkesës

1. Për çdo ngarkesë të produkteve organike dhe/ose në kalim, importuesi ose, sipas rastit, operatori përgjegjës për ngarkesën njofton paraprakisht për mbërritjen e ngarkesës në PIK:

a) institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK-un përkatës;

b) trupën e kontrollit, që certifikon operatorin përgjegjës për ngarkesën e importuar, së cilës i paraqet të gjithë informacionin e duhur lidhur me ngarkesën, emrin e eksportuesit, llojin e produktit, sasinë, vendin e origjinës, trupën e kontrollit që ka certifikuar eksportuesin dhe çdo informacion tjetër për gjurmueshmërinë e produktit.

2. Kur trupa e kontrollit gjatë kryerjes së verifikimit të dokumentacionit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, dyshon ose konstaton mospërputhje, që prekin integritetin e produkteve organike ose në kalim të një ngarkese, që do të importohet, njofton institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK dhe importuesin.

3. Njoftimi paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet minimalisht 24 (njëzet e katër) orë përpara mbërritjes së ngarkesës.

4. Lista e PIK-ëve miratohet sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin zyrtar.

Neni 6

Kontrollet zyrtare të ngarkesave

1. Kur ngarkesa e produkteve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 55, të ligjit, mbërrin në PIK, inspektori i institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK kryen kontrollin e ngarkesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar në PIK, për verifikimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi për prodhimin organik, si më poshtë vijon:

a) kontrollon dokumentacionin, për çdo ngarkesë të importuar;

b) kontrollon identitetin për çdo ngarkesë;

c) bën kontrollin fizik bazuar në riskun për mospërputhshmëri me legjislacionin në fuqi për prodhimin organik.

2. Kontrolli i dokumentacionit sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përfshin verifikimin e:

a) certifikatës së operatorit organik, eksportuesit, sipas nenit 3 të këtij vendimi dhe të importuesit;

b) dokumentacionit tregtar e të transportit, si faturat e ngarkesës, lista e produkteve dhe të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese të ngarkesës, përfshirë, sipas rastit, rezultatet e analizave ose të testeve të kryera në mostrat e marra.

3. Për ngarkesat e produkteve me rrezik të lartë, bazuar në procedurën e vlerësimit të riskut, inspektori kryen kontrollin e identitetit, kontrollin fizik dhe merr të paktën një mostër përfaqësuese të ngarkesës.

4. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK zbaton procedurën e vlerësimit të riskut për përcaktimin e produkteve me rrezik të lartë, sipas pikës 3 të këtij neni, bazuar në llojin e mospërputhshmërive të konstatuara, shkallën e rëndësisë ose përsëritjen e tyre, që ndikojnë në integritetin e produkteve organike ose në kalim dhe procedurën për marrjen e mostrës përfaqësuese, sipas kategorisë, sasisë dhe ambalazhimit të produktit.

5. Pas kryerjes së kontrollit zyrtar sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij neni, inspektori në PIK nxjerr aktin e kontrollit sipas natyrës së produktit, në të cilin përcaktohet statusi i ngarkesës së mëposhtme:

a) ngarkesa lejohet të futet në Shqipëri, si organike;

b) ngarkesa lejohet të futet në Shqipëri, si në kalim organike;

c) ngarkesa lejohet të futet në Shqipëri, si joorganike;

ç) një pjesë e ngarkesës lejohet të futet në Shqipëri, si organike ose në kalim;

d) ngarkesa nuk lejohet të futet në Shqipëri;

dh) një pjesë e ngarkesës lejohet të futet në Shqipëri, si joorganike.

6. Inspektori nxjerr aktin e kontrollit në 3 (tri) kopje, nga të cilat mban kopjen e parë, kopja e dytë i dorëzohet autoritetit doganor dhe kopja e tretë, importuesit.

Neni 7

Çlirimi për qarkullim të lirë nga autoritetet doganore

1. Autoritetet doganore lejojnë hyrjen në Republikën e Shqipërisë të ngarkesës për qarkullim



të lirë, pas kryerjes së kontrollit zyrtar nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK, i cili nxjerr aktin e kontrollit, sipas statusit të ngarkesës.

2. Bazuar në aktin e kontrollit dhe në dokumentet shoqëruese të ngarkesës së deklaruar nga importuesi ose përfaqësuesi doganor, si organik dhe/ose në kalim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë të dhënat e regjistruara në sistemin elektronik doganor, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 56, të ligjit.

Neni 8

Regjistrat dhe mbajtja e dokumentacionit

1. Importuesi, marrësi i parë dhe marrësi ruan, mban e administron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ngarkesën, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi.

2. Regjistrat dhe dokumentacioni që shoqëron ngarkesën, kur kërkohen, i paraqiten trupës së kontrollit, që kryen inspektimin e certifikimin e tyre si operator organik, si dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe kafshëve të gjalla në treg, me qëllim verifikimin e gjurmueshmërisë së produktit organik dhe/ose në kalim.

Neni 9

Përshkrimi i aktivitetit të importuesit

1. Në rastin e importuesit, që deklarohet një ngarkesë për të hyrë në Republikën e Shqipërisë si organik dhe/ose në kalim, përshkrimi i plotë i njësisë së prodhimit organik dhe aktivitetit të tij, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit, përfshin:

a) njësitë ose mjediset e ruajtjes e të tregtimit të produkteve organike dhe/ose në kalim;

b) aktivitetet që kryen importuesi, përfshirë informacionin për PIK-un, ku kryhet çlirimi për qarkullim të lirë të produkteve të importuara;

c) çdo mjedis, objekt tjetër që importuesi përdor për ruajtjen e produkteve të importuara në pritje të dorëzimit të tyre të marrësi i parë;

ç) marrjen përsipër për të siguruar që çdo mjedis ose njësi, që përdoret për magazinimin dhe ruajtjen e produkteve të importuara i nënshtrohet inspektimit e kontrollit nga trupa e kontrollit ose nga

institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar lidhur me ushqimin, ushqimin për kafshë dhe kafshëve të gjalla, që kryen kontrollin në treg.

2. Në rastin e marrësit të parë dhe të marrësit, përshkrimi sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin mjediset ose objektet, që përdoren për pranimin e ngarkesave dhe ruajtjen e tyre.

Neni 10

Informacioni që jepet për mospërputhshmëritë e dyshuara ose të konstatuara në ngarkesa

1. Kur inspektori në PIK, gjatë kryerjes së kontrollit zyrtar, sipas nenit 6 të këtij vendimi, dyshon ose konstaton mospërputhshmëri, që prekin integritetin e produkteve organike dhe/ose në kalim në një ngarkesë të importuar, ndërmerr veprimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare dhe menjëherë:

a) njofton importuesin dhe institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe kafshëve të gjalla, të rajonit ku ka destinacionin ngarkesa;

b) trupën e kontrollit të importuesit, të cilës i kërkon kryerjen e një hetimi zyrtar për rastin.

2. Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK ndalon përkohësisht vendosjen në treg të mallit ose të kafshës në fjalë si organik dhe/ose në kalim, në pritje të rezultateve të hetimit zyrtar, që kryhet nga trupa e kontrollit të importuesit.

3. Në varësi të rezultatit të hetimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, inspektori nxjerr aktin e kontrollit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6, të këtij vendimi.

4. Nëse rezultati i hetimit zyrtar, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, vërteton ndonjë nga rastet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 27, të ligjit, ngarkesa nuk çlirohet për qarkullim të lirë si organike ose në kalim.

5. Nëse rezultati i hetimit zyrtar sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, nuk i paraqitet institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar në PIK brenda 2 (dy) javësh, ngarkesa çlirohet për qarkullim të lirë si joorganike.

6. Importuesi mund të kërkojë çlirimin e ngarkesës si joorganike para marrjes së rezultatit të hetimit zyrtar.



Neni 11

Dispozita kalimtare

Pika 4, e nenit 3, të këtij vendimi, zbatohet deri më 31 dhjetor 2026.

Neni 12

Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, trupat e kontrollit, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar lidhur me ushqimin, ushqimin për kafshë dhe kafshët e gjalla dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më 29 tetor 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË**Nr. 756/10, datë 2.10.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës–Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TTA)’”, të ndryshuar, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 160 603 994.03 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë zero tre) lekë, me efekt financiar shtesë 96 881 119.30 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tridhjetë) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Hekurudha Shqiptare.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë

private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Vlerësimi i pasurive të llojit “arë”, “truall”, “kulturat bujqësore”, “vresht”, “tokë e pashfrytëzuar” dhe “investime”, janë llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 29/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit ‘Hekurudha Shqiptare – Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin e Rinastit’”, i ndryshuar; ligjin nr. 52/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit ‘Hekurudhat shqiptare – rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës’, në kuadër të grantit të investimit nga fondi i përbashkët evropian i Ballkanit perëndimor”, në bazë të të cilave është hartuar Raporti i Vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si më poshtë vijon:


Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat, të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Hekurudhës Shqiptare, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 160 603 994.03 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë zero tre) lekë, me efekt financiar shtesë 96 881 119.30 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tridhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

[illegible]

[illegible]



ULTRA-PARAMETER																				TESTING DATE: 2024-03-15 10:30 AM									
ID	NAME	AGE	SEX	WEIGHT (kg)	HEIGHT (cm)	BPM	BP (mmHg)	HRV (ms)	STRESS INDEX	SLEEP QUALITY	ACTIVITY LEVEL	HEALTH SCORE	REMARKS	DATE	TIME	LOCATION	STATUS	REVIEWER	APPROVED										
001	John Doe	35	M	75	180	72	120/80	50	10	8	High	95	Good	2024-03-15	10:30	Lab A	Active	Dr. Smith	Yes										
002	Jane Smith	28	F	60	165	68	110/70	45	5	Low	70	Good	2024-03-15	11:00	Lab B	Active	Dr. Jones	Yes											
003	Mike Brown	45	M	85	175	75	130/90	55	15	High	80	Fair	2024-03-15	11:30	Lab A	Active	Dr. Smith	No											
004	Sarah White	30	F	55	160	65	105/65	40	3	Low	65	Good	2024-03-15	12:00	Lab B	Active	Dr. Jones	Yes											
005	David Green	50	M	90	185	80	140/100	60	20	High	75	Fair	2024-03-15	12:30	Lab A	Active	Dr. Smith	No											
006	Emily Black	25	F	50	155	60	100/60	35	2	Low	60	Good	2024-03-15	13:00	Lab B	Active	Dr. Jones	Yes											
007	Chris Grey	40	M	70	170	70	125/85	50	12	High	78	Fair	2024-03-15	13:30	Lab A	Active	Dr. Smith	No											
008	Alice Blue	32	F	58	162	62	108/68	42	4	Low	68	Good	2024-03-15	14:00	Lab B	Active	Dr. Jones	Yes											
009	Bob Yellow	55	M	88	182	78	135/95	58	18	High	72	Fair	2024-03-15	14:30	Lab A	Active	Dr. Smith	No											
010	Grace Purple	22	F	48	152	58	98/58	32	1	Low	58	Good	2024-03-15	15:00	Lab B	Active	Dr. Jones	Yes											

**KËRKESË****Nr. 836/5, datë 2.10.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për një ndryshim në VKM-në nr. 61, datë 29.1.2025, ‘Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i fiderave me kabllo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias’, i ndryshuar” me vlerë totale paraprahe 17 208 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraparak të llogaritur.

a) Vlerësimi i pasurisë së llojit “arë” është llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 41/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas

ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a dhe KfW-së, Frankfurt *AM Main*, për programin e Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I”, për financimin e projektit: “Ndërtimi i fiderave me kabell 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias”. Raporti i vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a dhe miratuar nga Banka KfW-së, si më poshtë vijon.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprahe e shpronësimit 17 208 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 61, DATË 29.1.2025, ‘PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS’, I NDRYSHUAR”

Nr.	Nr. i shtyllës	Pronari		Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim					Shënime (kuftizime hipotekare, burime mbi pasuritë, etj.)
											"Arë"/ Çmimi		Vlera e dru-frutoretëve (lekë)	Vlera totale (lekë)		
Emër	Atesia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)				
8	K15/V4	Armand Denisa	Hamdi Ramazan	Çela Çela	Valias	1514	380/91	Arë	2761	9	110	24	717	17208	17208	
Vlera totale															17208	

Shënim. Efekti financiar shtesë, për pasuritë të cilat kërkohet të ndryshohen të dhënat e pronësisë, është me efekt 0, pasi vlera e tyre është pasqyruar në VKM-në bazë nr. 61, datë 29.1.2025, konkretisht në numrin rendor 8.

**KËRKESË****Nr. 258/9, datë 3.10.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i sipërfaqes së varrezave publike të qytetit të Peqinit’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Peqin.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 940.000 lekë (nëntëqind e dyzet mijë lekë), bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës

në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Peqin, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit në lidhje me projektin e sipërcituar është 940.000 lekë (nëntëqind e dyzet mijë lekë).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “ZGJERIMI I SIPËRFAQES SË VARREZAVE TË QYTETIT TË PEQINIT”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekare								Vlerësimet për shpronësim						Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizi-me hipote-kare barë mbi pasurinë etj.)	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Qyteti	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Aër (m²)	Ndër-tesë (m²)	Vol.	Fa-qe	Aër			Ndërtesë				
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)			Vlera (lekë)
1	Vale Xhaferi Haxhemija Zybah Xhaferi Haxhemija Myrteza Xhaferi Haxhemija Ethem Xhaferi Haxhemija Sulejman Xhaferi Haxhemija			Peqin	3055	232/7	ARË	20700	4000	0	2	74	4000.00	235.00	940,000.00	0	0	0	940,000.00	
	Vlera paraprake e shpronësimit																		940,000.00	lekë

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

